



MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 249, dt. 18.12.2015

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 18.12.2015, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për hapjen e një hyrjeje të re në fasadën e pasme të objektit nr. 2 të ALBtelecom në rrugën “Myslym Shyri”, Tiranë.
 2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI